



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 5175 Prot.

Tiranë, më 28.9 2020

UDHËZIM

Nr. 23, datë 28.9 2020

PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, sipas vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

U D H Ë Z O J:

1. Në Kreun VI, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020 të ndryshuar, pas pikës 5/2, shtohet pika 5/3 me këtë përmbajtje:

"5/3. Përfundimisht, aplikimet për programet e studimit për vitin akademik 2021-2022, do të pranohen deri në 31 dhjetor të vitit 2020".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI

Evis KUSHI

